

Njoftim për përqendrim me të cilin personi AM nga Mali i Zi, Menzies Aviejshn (Jurop) B.V. Holandë dhe Air SERBIA a.d. Beograd dhe Serbia do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi MENZIES AVIEJSHN SHPK BEOGRAD-SURÇIN, Serbi

(lënda nr. 08-123/2024)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 20.08. 2024, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin personi AM, Mali i Zi, Menzies Aviejshn (Jurop) B.V., me seli në Anhoragelaan 50, 1118 Shiphol, Holandë dhe Air SERBIA a.d. Beograd me seli të regjistruar në Jurija Gagarina 12, Beograd-Nov Beograd, Republika e Serbisë *synojnë të fitojnë kontroll të drejtpërdrejtë të përbashkët mbi* MENZIES AVIEJSHN SHPK BEOGRAD-SURÇIN, me seli të regjistruar në Aeroportin Nikola Tesla, Zyra nr. 3, pjesa hyrëse me Terminalin 1, Surçin, Republika e Serbisë.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit

AM është person fizik me vendbanim në Mal të Zi dhe ortak në Menzies Serbi.

Personi AM nuk ka shoqëri të regjistruara në Maqedoninë e Veriut.

Veprimtaria kryesor e **Menzies Aviejshn (Jurop) B.V.** është ofrimi i shërbimeve të sigurta dhe efikase të aviacionit (shërbimet e transportit tokësor (groundhandling services)dhe shërbimet e ngarkesave ajrore).

Menzies Aviejshn (Jurop) B.V. nuk ka shoqëri të lidhura të regjistruara në Maqedoninë e Veriut.

Veprimtaria e regjistruar e Air SERBIA a.d. Beogradi është 5110 - transporti ajror i pasagjerëve. AC gjithashtu transporton sasi të mëdha ngarkesash dhe poste në fluturimet e saj të planifikuara si pjesë integrale e biznesit të saj.

Air SERBIA a.d. Beogradi, ka një shoqëri të varur të regjistruar në Maqedoninë e Veriut - Shoqëria e trafikut ajror AEROMAK SHPKNJP Shkup, me seli në Bul.. Partizanski Odredi nr 17, Shkup, Maqedonia e Veriut me veprimtari AEROMAK SHPKNJP Shkup 51.10 - transport ajror i pasagjerëve.

Veprimtaria e regjistruar e **MENZIES AVIEJSHN SHPK BEOGRAD-SURÇIN** është 5223 - aktivitete shërbimi në trafikun ajror.

MENZIES AVIEJSHN SHPK BEOGRAD-SURÇIN nuk ka shoqëri të regjistruara të lidhura në Maqedoninë e Veriut

Parashtruesi i njoftimit konsideron se si tregje relevante për përqendrimin në fjalë mund të përcaktohet tregu për shërbimet tokësore të aeroportit(groundhandling services).

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email:

kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

30.08.2024

Shkup